



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KESHILLI

Nr. 1063 / prot

Koplik më: 03 / 06 / 2021

V E N D I M

Nr 33 datë 28 / 05 / 2021

PËR

1. "Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të z. Mark Goraj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit. si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit z. Mark Goraj nga programi Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 3280, në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr 2 datë 11.01.2021 "për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afat mesem 2021-2023 të Bashkisë Malësi e Madhe".

Baza Ligjore

Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar

Ligji për Prefektin e Qarkut

Ligji Nr. 45/2019 Për mbrojtjen civile,

VKM nr.329 datë 16/5/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"

VKM, Nr.965, datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

Vendosi;

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetasit z. Mark Goraj, objekti shtëpi banimi e të cilës është dëmtuar nga rënia e zjarrit,.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko - ligjor përkatës të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për demtimin e banesë nga rënia e zjarrit.

3. T'i akordojë familjes së shtetasit Z. Mark Goraj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, dhënien e ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vleren/shumen 100.000 (njëqind mijë) lekë , në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr.2, datë, 11.01.2021 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 të Bashkisë Malësi e Madhe " ,nga fondi i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe, nga Programi "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, programi 3280".

4. T'i paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të familjes së shtetasit Z. Mark Goraj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.

5. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Z. Mark Goraj, përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.



6. Ndhimja financiare që do të akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit **Z. Mark Goraj**, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.

7. Vlera e dëmeve në orëndi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake është 257.780 (dyqind e pesëdhjetë e shtate mije e shtateqind e tetëdhjetë) leke.

Vlera në total e dëmeve është : 257.780 (dyqind e pesëdhjetë e shtate mije e shtateqind e tetëdhjetë) leke.

8. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 28.05.2021

Vota Pro 20

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 31.05.2021

